



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12 paragrafët 1 dhe 2 shkronja d), neneve 24.2; 40 paragrafët 1 dhe 2 shkronja c) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, neneve 2 dhe 8 të Ligjit për financat e pushtetit lokal nr.03/L-049, si dhe neneve 14, 15 paragrafët 1 dhe 2.4; neneve 21.2; 34 paragrafët 1 dhe 2.3, të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, në propozim të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave nr.prot.01-016/01-0040849/23 të datës 15.06.2023, Kuvendi i Komunës së Podujevës, më 03 korrik 2023 vazhdim i mbledhjes së datës 29 qershor 2023, miratoi këtë;

V E N D I M

PËR FALJEN E OBLIGIMEVE TË KRIJUARA / BORXHEVE NGA QIRATË NË TREGUN E QYTETIT TË PODUJEVËS

Neni 1

Me këtë vendim falen obligimet / borxhet e krijuara ndaj Komunës së Podujevës nga qiratë në Tregun e Qytetit të Podujevës për të gjithë shfrytëzuesit e Lokaleve dhe hapësirave tjera / Tezgave sipas kontratave dhe dokumenteve përkatëse në bazë të të cilave kanë qenë shfrytëzues të tyre, dhe atë deri më 12.06.2023, në shumë të gjithmbarshme 386,760.85 € (*treqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë euro e tetëdhjetë e pesë cent*), sipas listave përkatëse të paraqitura me raportin nr.prot.02-016/01-0040045/23 datë 12.06.2023 të DPKGJ, pjesë përbërëse të këtij vendimi.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi, do të kujdesen Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, si dhe Drejtoritë tjera varësisht fushës së veprimit që mund të jenë të përfshira në këtë çështje.

Neni 3

Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.Prot: 01-360/05-0045370/23
Podujevë, datë: 03 korrik 2023

